

**AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQËRISË ME ORTAK TË VETËM**

“ON TIME TAXI” SHPK

KAPITULLI I

KRIJIMI, FORMA, QELLIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, EMËRTIMI, SELIA

NENI 1

KRIJIMI I SHOQËRISË

1. Sot më datë 08.09.2025 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “ON TIME TAXI” shpk.
2. Shoqëria është person juridik shqiptar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar.
3. Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar që prej datës, në të cilën organet kompetente kanë dhënë aprovimin për themelimin e saj.
4. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

NENI 2

FORMA E SHOQËRISË

1. Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie nuk do të marrin një vendim për shndërrimin e saj.
2. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet sipas radhës nga dispozitat e këtij statuti dhe dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, për aq kohë sa dispozitat e këtij statuti nuk vijnë në kundërshtim me ligjin e mësipërm.

NENI 3

EMËRTIMI

Emërtimi i shoqërisë është “ON TIME TAXI” sh.p.k . Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet sh.p.k.

NENI 4

SELIA E SHOQËRISË

1. Shoqëria e ka selinë në Tiranë, në adresën: Rr. Lucie Miloti, ND 26, Kati 1, Hyrja 2, ZK 8522 Njesia Adm nr 4, Tiranë, Shqipëri.
2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm.

NENI 5

KOHËZGJATJA

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat
2. Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të pezullojë veprimtarinë e saj në cdo kohë e kur e shihet të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 6

QËLLIMI DHE OBJEKTI

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:
1.1 Sherbim Taxi, Dhenie e automjeteve me Qira, Shitje dhe blerje automjeteve, shitje blerje dhe dhenie me qira e pronave, si dhe cdo veprimtari tjetër e lejuar nga legjislacioni në fuqi.
2. Shoqëria mund të ndryshojë dhe të shtojë në cdo kohë objektin e veprimtarisë së saj sipas rregullave të parashikuara në statutin e saj dhe në legjislacionin tregtar.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, ORTAKU, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

NENI 7

KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 1 000 000 (një milion) Lek. Kontributi i Ortakut përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
2. Ortaku i Vetëm është zotëruar i një kuote në masën 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 1 000 000 lekë, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emri i Ortakut	Kuota	Vlera	Përqindja %
1.	Ilirjan Gecaj	1	1 000 000 lek	100
TOTALI		1	1 000 000 lek	100

NENI 8

ORTAKU I VETËM DHE KUOTAT

1. Shoqëria përbëhet nga një Ortak i Vetëm, me të dhënat e mëposhtme:
 - Ilirjan Gecaj, lindur më 09/05/1995 në Durrës dhe banues në Tiranë, e cila zotëron 1 kuotë në masën 100 % të kapitalit të shoqërisë.
2. Ortaku i Vetëm i shoqërisë zotëron një kuotë në masën 100 % me vlerë 1 000 000 (një milion) lek.

NENI 9

MENYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a. Kontributit të ortakëve në kapitalin e shoqërisë;
 - b. Shit-blerjes;
 - c. Trashëgimisë;
 - d. Dhurimit;
 - e. Çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

NENI 10

PASOJAT E KALIMIT TË KUOTAVE, PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e përfiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotes, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të nenit 74 të Ligjit për shoqëritë tregtare.
2. Shoqëria realizon kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
3. Kuotat janë lirisht të transferueshme midis ortakëve të shoqërisë. Rregulli i kushtëzimit të transferimit nuk zbatohet në rast të transferimit për shkak trashëgimie ose transferimit tek pjesëtarët e familjes.

KAPITULLI III

MARREDHENIET NDERMJET SHOQËRISE DHE ORTAKEVE

NENI 11

SHPËRNDARJA E FITIMEVE

1. Ortaku ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë që janë miratuar nga një ekspert kontabël i miratuar dhe nga Asambleja e Ortakut të Vetëm me Vendim. Shoqëria mund të mos ndajë fitim edhe kur realizon fitim, nëse mbledhja e asamblesë ka vendosur për këtë qëllim.
2. Administratori i shoqërisë në rastin e shpërndarjes së fitimit duhet që dokumentin përkatës që autorizon strukturën përkatese për kalimin e fitimeve tek Ortaku i Vetëm i shoqërisë, ta shoqërojë me Vendimin përkates të Asamblesë.

NENI 12

KUFIZIMET E SHPËRNDARJES, ÇERTIFIKATA E AFTËSISË PAGUESE, PËRGJEGJËSITË

1. Shoqëria mund të shpërndajë fitimin për Ortakun e Vetëm, vetëm nëse pas pagimit të fitimit:
 - a. Aktivët e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12-muajve në vazhdim.
2. Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e fitimit përmbush kërkesat e paragrafit të parë të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë



tregon se shpërndarja e propozuar e fitimit nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund të lëshojë këtë certifikatë.

3. Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikates së aftësisë paguese.
4. Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e fitimit të shpërndarë.
5. Ortaku, që ka marrë nga shoqëria fitim, përgjigjet personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e tij, pavarësisht lëshimit të certifikatës, nëse ka pasur dijeni për gjëndjen e paaftësisë paguese të shoqërisë sipas paragrafit të parë të këtij neni.

KAPITULLI IV

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË


Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- 1. Asambleja e Ortakut të Vetëm**
- 2. Administratori**

NENI 13

ASAMBLEJA E ORTAKUT TË VETËM TË DREJTAT DHE DETYRAT

1. Asambleja e Ortakut të Vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :
 - a. Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b. Ndryshimet e statutit;
 - c. Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit ;
 - d. Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d, të kësaj pike ;
 - f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
 - g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
 - h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
 - j. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit ;
 - k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l. Për miratimin e marrjes së audituesve të jashtëm, në rastet e hetimeve të posacme;
 - m. Miratimin e strukturës së shoqërisë dhe nivelet e pagave për vend pune;
 - n. Shpërndarjen e fitimeve për ortakët;
 - o. Miratimin e marrjes së kredive bankare;
 - p. Krijimin dhe përdorimin e fondit rezervë të shoqërisë;
 - q. Shndërrimin e formës së shoqërisë dhe/ose bashkimin me shoqëri të tjera, apo pjesëmarrjen në shoqëri apo grupe shoqërishe;



- r. Miratimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të regjistrit të shoqërisë për regjistrimin e vendimeve të shoqërisë, dhe strukturën përgjegjëse për administrimin e tij;
 - s. Miratimin e rregulloreve të ndryshme të punës si dhe rregulloreve të tjera që në thelb kanë të bëjnë me procese të rëndësishme të veprimtarisë së shoqërisë ;
 - t. Miratimin në rastin e shitblerjes së koutave të ortakeve ose formave të tjera të transferimit të tyre, sipas parashikimeve të këtij statuti.
 - u. Miratimin në rastet e dhënies apo marrjes me qira të sendeve prodhuese të luajtshme.
2. Duhet regjistruar në veçanti sipas ligjeve në fuqi, por pa u kufizuar në to, vendimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm:
- a. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c. Investime;
 - d. Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
 - e. Vendime të tjera që asambleja e përgjithshme vlerëson se duhen regjistruar.
3. Të gjitha Vendimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm ruhen në një regjistër të veçantë, sipas numrit dhe datës. Administratori përgjigjet për rregullsinë e regjistrit. Vendimet e paregjistruara në Regjistrin e Vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të kishte pasur dijeni për të.

NENI 14

ADMINISTRATORI

EMËRIMI, SHKARKIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

- 1. Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit nuk mund të jetë më i gjatë se 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e Ortakut të Vetëm merr vendim të posaçëm për riemërimin e Administratorit pas periudhës së emërimit të parë.
- 2. Caktimi i Administratorit bëhet nga ky statut për një periudhë 5 (pese) vjecare me të drejtë riemërimi nga Ortaku i Vetëm. Administrator i shoqërisë është caktuar Ilirjan Gecaj, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, lindur me datë 11/04/1992 në Fierze, ALB , mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal J20411061N dhe banuese në Tiranë.
- 3. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
 - a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare;
 - b. përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrëdhënie me të tretet, personalisht ose me përfaqësim, tek palët e treta, institucione apo entitete publike;
 - c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d. mbajë një regjister të veçantë ku të bëjë regjistrimin e të gjitha Vendimeve të Ortakut të Vetëm.
 - e. mbajë korespondencë të rregullt me të tretët, si dhe të marrë të gjitha masat që kjo të jetë e arkivuar në arkivën e shoqërisë;
 - f. lidhë kontratat e punës me punonjësit e shoqërisë;



- g. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve,
- h. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- i. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në këtë statut apo sipas ligjit;

NENI 15 **PËRFAQËSIMI**

1. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim sipas ligjeve në fuqi.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

NENI 16 **SHPËRBLIMI**

1. Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa. Shtesat bëhen me vendim të asmblesë së Ortakut të Vetëm.
2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit, gjendjen financiare të shoqërisë dhe të respektojë nivelet minimale të kërkuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 17 **VITI FINANCIAR, BILANCI, KONTABILITETI, HUMBJET DHE FITIMET**

1. Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të çdo viti. Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.
2. Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakut të Vetëm dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
3. Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së vitit financiar, pas pagimit të detyrimeve, i kalojnë Ortakut të Vetëm.
4. Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe Ortaku do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e vitit financiar të parë deri në tre vitet pasardhës.

NENI 18

EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR

1. Ortaku mund të emërojë një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.
2. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike-tregtare të Shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe i ka kryer këto duke qenë i ngarkuar nga Ortaku.
3. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të raportit vjetor, si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë Ortakut për t'i shqyrtuar dhe miratuar mbi bazën e të drejtës së tij vendimmarrëse.

KAPITULLI V

PRISHJA E SHOQËRISË, LIKUIDIMI

NENI 19

SHKAQET E PRISHJES SË SHOQËRISË

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
 - a. me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - b. në rast se objekti bëhet i paralizueshem apo për shkak të tjerave që bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - c. në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit tregtar;
 - d. në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - e. në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - f. për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Ortakut të Vetëm.
2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara më sipër, vendoset nga Asambleja e Obgortakut të Vetëm të shoqërisë.
3. Me Vendimin e Asamblesë së Ortakut të Vetëm, caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.

NENI 20

REGJISTRIMI I SHPËRBËRJES

1. Administratori ka detyrë të regjistrojë shpërbërjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin sipas ligjeve në fuqi.

2. Në rastin e shpërbërjes së shoqërisë, pavarësisht institucionit që ka marrë vendimin asamblesë dhe/ose gjykatës, ngarkohet administratori që të kryejë procedurat deri në përfundim të këtij procesi, për aq kohë sa, kjo dispozitë e statutit nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

NENI 21

LIKUIDIMI NË GJENDJEN E AFTËSISË PAGUESE

1. Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

NENI 22

PROCEDURA E SHNDËRRIMIT


1. Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore me miratimin e Ortakut, nëpërmjet shndërrimit, sipas procedurës së parashikuar në Ligjin Tregtar.
2. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve. Marrëdhëniet e brendshme në fushën e menaxhimit dhe administrimit të Shoqërisë midis administratorit, Ortakut, dhe çdo të punësuar në Shoqëri, do të rregullohen me anën e një rregulloreje të miratuar nga Ortaku.
3. Shndërrimi njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me Ligjin Tregtar.

NENI 23

DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

1. Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut që lidhet me funksionimin e shoqërisë, zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi në momentin e nënshkrimit të këtij statuti.
2. Në çdo rast kur legjislacioni shqiptar përkatës mund të ndryshojë, ky statut me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, sipas rregullave të përcaktuara mund të ndryshohet, në përputhje me ndryshimet përkatëse të legjislacionit në fuqi.
3. Ky statut hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij dhe prodhon efekte ndaj të tretëve nga data e regjistrimit të tij në QKB.
4. Ky Statut u hartua dhe u nënshkrua nga unë Ortaku i Vetëm, Ilirjan Gecaj, sot më 08/09/2025

ORTAKU I VETËM


Ilirjan Gecaj

